Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0963

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë kundër Vendimit për dhënie të një kontrate lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rivlersim i Aseteve te NP"Termokos"Sh.A" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.sha-23-11074-2-2-1", iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A ., më 30/01/2024, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë me nr. 2023/963, e datës 01/12/2023, kurse vendimi i AK Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rivlersim i aseteve te NP "Termokos"Sh.A" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.Sha-23-11074-2-2-1", anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

4. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale --
Me: 13.10.2023, "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Rivlersim i aseteve te NP "Termokos"Sh.A" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.sha-23-11074-2-2-1". Ndërsa me datën 10.11.2023 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë OE "PMB Global SH.P.K"- Prishtinë.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 70,000 €.
Me 15.11.2023, OE "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 22.11.2023, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.
Me 01.12.2023, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë me nr. 963/23 për lidhur me aktivitetin "Rivlersim i aseteve te NP "Termokos"Sh.A" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.sha-23-11074-2-2-1",
-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-
Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.
Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë *janë parashtruar si në vijim:*

Pretendimi i parë (I):. "Neni 1: Qëllimi Autoriteti kontraktues shkel te 3 paragrafët e nenit 1 te ligjit per prokurim publik. Përderisa paragrafi 1 thotë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Autoriteti kontraktues e shkel nenin 1 te LPP-se ne te tri paragrafët duke e validuar ofertën e operatorit ekonomik "PMB Global ShPK" dhe dukje e rekomanduar për dhenje te kontratës. Neni 7 i LPP se Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi: Autoriteti kontraktues ka ber shkeljen e paragrafit te pare dhe ne tersi nenin 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminim te Ligjit për Prokurim Publik, duke e rekomanduar për dhenje te kontratës një operator ekonomik i cili as për se afërmi nuk i plotëson kërkesat e dosjes tenderike. Ne kemi shpenzuar kohe dhe mjete financiare për te përgatitur oferte sipas kërkesës se autoritetit kontraktues, ndërsa AK e rekomandon për dhenje te kontratës operatorin, i cili si përmbush këto kërkesa, pa liste te stafit, pa referenca për pune te ngjashme, pa referenca te stafit. Neni 59 i LPP-së : Egzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik duke E rekomanduar për dhenje te kontratës operatorin ekonomik "PMB Global ShPK" edhe pse oferta e tij nuk është e përgjegjshme bazuar ne kriteret dhe kërkesat e dosjes tenderike. Kriteret te cilat nuk i ka përmbush operatori ekonomik i rekomanduar për dhenje te kontratës, janë kritere kualifikuese (kalon/nuk kalon). Prandaj ne rastin e mos përmbushjes se kërkesave, autoriteti kontraktues duhet qe ne baze te LPP-se te bej eliminimin e këtij operatori ekonomik. Tek aftësitë teknike profesionale autoriteti kontraktues ka kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ketë realizuara me sukses kontrata/Referenca në vlere minmum 70,000.00 euro për shërbimet të natyrës së ngjashme në 3 vitet e fundit Dëshmia e kërkuar: 1.Listën e kontratave që specifikon: Shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certifikatë të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë". Ndërsa nga dokumentacioni i ofruar nga

qasja ne dokumente zyrtare qe kemi bere pran autoritetit kontraktues, rezulton se oferta e operatorit ekonomik nuk e plotëson këtë kërkesë, ngase nga referencat e bashkangjitura dhe kontratat nuk përmbush këtë kriter pasi qe edhe nëse përfshihen kontratat e natyrës se ngjashme te bashkangjitura për te cilat nuk ka reference ose vërtetim te livirimit te shërbimeve shuma totale (58,316.52 euro) është nen 70 mije euro e përcaktuar ne kriteret e dosjes se tenderit. Ndërsa, referencat e bashkangjitura janë vetëm për shumen 42,356.52 Euro qe është përsëri nen shumen 70 mije euro. Nëse shikohet Lista e kontratave për vitin 2023 te dorëzuar nga OE, ka shënuar qarkullimin prej 50 mije euro përderisa nga dëshmia e TEB bankës qarkullimi figuron 45,514.00 euro. Gjithashtu ne kërkesën tjetër: "Lista e stafit duhet të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperienca (vitet) dhe pozicioni në kompani"

Ky dokument fare nuk është dorëzuar nga kompania e rekomanduar për dhenje te kontratës. Gjithashtu autopriteti kontraktues ne dosjen e tenderit tek aftesit teknike dhe profesionale ka kërkuar: 2.OE duhet të prezantoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt të ketë : 1.Inxhinjer elektrikes 1.1nxhinjer i makinerisë, 1.2nxhinjer i ndërtimtarisë, 4.Ekspert gjyqësorë financiar i licencuar nga KGJK 5.Ekspert për vlerësim të pasurisë së paluajtshme i licencuar 6.Kontabilist të certifikuar/Auditor i brendshëm i certifikuar, 6.1.1. CV, diploma origjinal ose e noterizuar , kontrata e punës me ofertuesin e nënshkruar nga të dy palët ,referenca për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit, 4.5.6- CV, Licenca /Certifikata origjinal ose e noterizuar valide , kontrata e punës me ofertuesin e nënshkruar nga të dy palët ,referenca për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit. Ndërsa operatori ofertues i rekomanduar për dhenje te kontratës nuk i përmbush këto kritere ngase Për pozitën inxhinjeri i makinerisë kompania nuk ka dorëzuar referencat për punët e mëparshme të stafit të propozuar. Për pozitën inxhinjer i ndërtimtarisë diploma nuk është e noterizuar si dhe vërtetimi I noterit nuk tregon se cfarë kopje është si dhe nuk përkon me vulën që është vendosur në diplomën ku edhe vula e noterit është kopje. Për këtë staf gjithashtu mungojnë referencat për punët e mëparshme të personit të propozuar. Ekspert financiar gjyqësor nuk ka asnjë referencë për punë të ngjashme. Ekspert për vlerësim të pasurisë së paluajtshme i licencuar asnjëri nga stafi I propozuar nuk ka asnjë referencë për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit. Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve: Autoriteti kontraktues ka bere shkelje te nenit 65 me rastin e validimit te operatorit ton ekonomik si "PMB Global ShPK" operator i përgjegjshëm, edhe pse oferta e tij nuk përputhet me kërkesat e dosjes tenderike. Mos te harrojmë kriteret te cilat nuk i ka përmbush operatori ekonomik i rekomanduar për dhenje te kontratës, janë kritere kualifikuese (kalon/nuk kalon), prandaj autoriteti kontraktues ka bere shkelje te rend me rasti e rekomandimit për dhenje te kontratës te një oferte e cila nuk i përmbush as për se afërmi kërkesat e dosjes tenderike. Neni 69 i LPP-së- Aftësia teknike dhe profesionale: Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 69 te Ligjit te Prokurimit Publik duke E rekomanduar për dhenje te kontratës operatorin ekonomik "PMB Global ShPK" edhe pse oferta e tij nuk është e përgjegjshme bazuar ne kriteret dhe kërkesat e dosjes tenderike. Tek aftësitë teknike profesionale autoriteti kontraktues ka kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ketë realizuara me sukses kontrata/Referenca në vlere minmum 70,000.00 euro për shërbimet të natyrës së ngjashme në 3 vitet e fundit Dëshmia e kërkuar: 1.Listën e kontratave që specifikon: Shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certifikatë të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë". Ndërsa nga dokumentacioni i ofruar nga qasja ne dokumente zyrtare qe kemi bere pran autoritetit kontraktues, rezulton se oferta e operatorit ekonomik nuk e plotëson këtë kërkese, ngase nga referencat e bashkangjitura dhe kontratat nuk përmbush këtë kriter pasi qe edhe nëse përfshihen kontratat e natyrës se ngjashme te bashkangjitura për te cilat nuk ka reference ose vërtetim te livirimit te shërbimeve shuma totale

(58,316.52 euro) është nen 70 mije euro e përcaktuar ne kriteret e dosjes se tenderit. Ndërsa, referencat e bashkangjitura janë vetëm për shumen 42,356.52 Euro qe është përsëri nen shumen 70 mije euro. Nëse shikohet Lista e kontratave për vitin 2023 te dorëzuar nga OE, ka shënuar qarkullimin prej 50 mije euro përderisa nga dëshmia e TEB bankës qarkullimi figuron 45,514.00 euro. Gjithashtu ne kërkesën tjetër: "Lista e stafit duhet të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperienca (vitet) dhe pozicioni në kompani". Ky dokument fare nuk është dorëzuar nga kompania e rekomanduar për dhenje te kontratës. Gjithashtu autopriteti kontraktues ne dosjen e tenderit tek aftësitë teknike dhe profesionale ka kërkuar: 2.OE duhet të prezantoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt të ketë : 1.Inxhinjer elektrikes, 2.Inxhinjer i makinerisë, 1.1 nxhinjer i ndërtimtarisë, 4.Ekspert gjyqësorë financiar i licencuar nga KGJK ,5.Ekspert për vlerësim të pasurisë së paluajtshme i licencuar, 6.Kontabilist të certifikuar/Auditor i brendshëm i certifikuar, 6.1.1. CV, diploma origjinal ose e noterizuar , kontrata e punës me ofertuesin e nenshkruar nga të dy palët ,referenca për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit, 4.5.6- CV, Licenca /Certifikata origjinal ose e noterizuar valide , kontrata e punës me ofertuesin e nënshkruar nga të dy palët ,referenca për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit. Ndërsa operatori ofertues i rekomanduar për dhenje te kontratës nuk i përmbush këto kritere ngase Për pozitën inxhinjeri i makinerisë kompania nuk ka dorëzuar referencat për punët e mëparshme të stafit të propozuar. Për pozitën inxhinjer i ndërtimtarisë diploma nuk është e noterizuar si dhe vërtetimi I noterit nuk tregon se çfarë kopje është si dhe nuk përkon me vulën që është vendosur në diplomën ku edhe vula e noterit është kopje. Për këtë staf gjithashtu mungojnë referencat për punët e mëparshme të personit të propozuar. Ekspert financiar gjyqësor nuk ka asnjë referencë për punë të ngjashme. Ekspert për vlerësim të pasurisë së paluajtshme i licencuar asnjëri nga stafi I propozuar nuk ka asnjë referencë për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit. Neni 108/A i LPP-së- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve. Autoriteti kontraktues shkel nenin 108/A me rastin e rishqyrtimit sipërfaqësor te kërkesës sonë për rishqyrtim. Nga 5 pretendime ankimore te ngritura nga ana jone, nga vendimi i AK-se i datës 22.11.2023 i paska rishqyrtuar vetëm 3 prej tyre. Madje edhe ato shkel e shko. Mjafton te shihni vendimin e AK ku dokumenti nuk është i strukturuar. Mjafton te shikoni arsyetimin nr.3 "3.(Pretendimi Nr.3) Sipas A.K. është i pabazuar sipas kërkesës te D.T. dhe njoftimit për kontrate sepse është devijim substancial qe nuk ndryshon vendimin e A.K.", Kur te gjeturat janë substanciale, ato automatikisht do duhej te ndryshonin vendimin e AK. Me rastin e qasjes ne dokumente zyrtare, neve na janë paraqitur dokumentet e ofertës se operatorit ekonomik, por jo edhe sqarimet qe AK pretendon se i paska kërkuar OE te rekomanduar për dhenje te kontratës. Pra AK me qellim apo pa qellim, nuk na i ka ofruar dokumentet sqaruese qe OE i paska dorëzuar me datën 08.11.2023. Pra AK ka bere shkelje te rend me rastin e mos dhenjes qasje te plot ne dokumente zyrtare."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 59, 65, 69,108/A të LPP-së atëherë kërkojmë nga OSHP-Organi Shqyrtues i Prokurimit. t'a kthej këtë procedure te prokurimit ne procesin e Ri-Vlerësimit .

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Zyra e Prokurimit , ka pranuar përgjigjeje me datë : 22.11.2023 nga (Njësia kërkuese Departamenti i Financave përmes e-mailit si në vijime: Në lidhje me shkresën paraprake, sqarojmë: I .(Pretendimi Nr. l) Sa i përket vlerës se referencave është kërkuar sqarim shtesë nga A.K."Termokos"SH.A. me datë:03.11.2023 përmes platformës se E-Prokurimit ,andaj OE. fitues është përgjigjur ne sqarimin e A.K. me datë:08.11.2023 me çka dëshmon se ka plotësuar kriterin e kërkuar. 2. (Pretendimi Nr.2) Sipas A.K. është i pa bazuar

sipas kërkesave te D. T. dhe njoftimit për kontrate. 3, (Pretendimi Nr.3) Sipas A.K. është i pa bazuar sipas kërkesave te D. T. dhe njoftimit për kontrate sepse është devijim substancial qe nuk ndryshon vendimin e A.K. Duke u bazuar ne njoftimin për kontrate neni IV.2) Kriteret e Dhënies -Çmimi më i ulët i ofruar ,A.K. ka vepruar konform nenit IV.2 te L.P.P.-së. Autoriteti Kontraktues ka trajtuar ne mënyrë te barabarte te gjithë operatoret ekonomik ne garë konforme dispozitave te LPP-së. Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi: 1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik."

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 19/12/2023 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 963/2023, ndërsa me datë 01/01/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/963 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.
Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues është Pajtuar pjesërisht . OE Pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.
Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.
- Administrimi dhe vlerësimi i provave –
Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.
Lidhur me pretendimet e OE "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0963 ka vlerësuar si në vijim:
Sqarim hyrës: "OE ankues ka ngritur disa pretendime, prej të cilave dy nga këto pretendime janë pretendime ankimore, për të cilat eksperti shqyrtues ka dhënë përgjigje si më poshtë."
Konstatimi i parë (I) dhe i dytë (II): "OE ankues pretendon se AK ka shkelur nenin 1 dhe nenin 7 të LPP-së".Pretendimi i parë dhe i dytë të ngritur nga OE ankues nuk janë pretendime ankimore, sepse nuk përmbajnë asnjë fakt apo provë e cila mund të shqyrtohet nga ana e ekspertit shqyrtues."
Konstatimi i tretë (III): "Autoriteti Kontraktues ka bere shkelje te nenit 59 te Ligjit te Prokurimit Publik duke E rekomanduar për dhenje te kontratës operatorin ekonomik "PMB Global ShPK" edhe pse oferta e tij nuk është e përgjegjshme bazuar ne kriteret dhe kërkesat e dosjes tenderike. Tek aftësitë teknike profesionale autoriteti kontraktues ka kërkuar "Operatori ekonomik duhet të ketë realizuara me sukses kontrata/Referenca në vlere minmum 70,000.00 euro për shërbimet të natyrës së ngjashme në 3 vitet e fundit Dëshmia e kërkuar: 1.Listën e kontratave që specifikon: Shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certifikatë të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë". Ndërsa nga dokumentacioni i ofruar

nga qasja ne dokumente zyrtare qe kemi bere pran autoritetit kontraktues, rezulton se oferta e operatorit ekonomik nuk e plotëson këtë kërkesë, ngase nga referencat e bashkangjitura dhe kontratat nuk përmbush këtë kriter pasi qe edhe nëse përfshihen kontratat e natyrës se ngjashme te bashkangjitura për te cilat nuk ka reference ose vërtetim te livirimit te shërbimeve shuma totale (58,316.52 euro) është nen 70 2/3 mije euro e përcaktuar ne kriteret e dosjes se tenderit. Ndërsa, referencat e bashkangjitura janë vetëm për shumen 42,356.52 Euro qe është përsëri nen shumen 70 mije euro. Nëse shikohet Lista e kontratave për vitin 2023 te dorëzuar nga OE, ka shënuar qarkullimin prej 50 mije euro përderisa nga dëshmia e TEB bankës qarkullimi figuron 45,514.00 euro." Eksperti shqyrtues sqaron se një nga kërkesat e Dosjes së Tenderit sa i përket kapacitetit teknik dhe profesional ka qenë që: "Operatori ekonomik duhet të ketë realizuara me sukses kontrata/Referenca në vlere minmum 70,000.00 euro për shërbimet të natyrës së ngjashme në 3 vitet e fundit." dhe si dëshmi dokumentare për këtë kërkesë është kërkuar: "Listën e kontratave që specifikon: Shërbimet e përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin, duke i bashkëngjitur dëshmitë përcjella me certifikatë të livrimit-dorëzimit të mirë (kopje) ose referencë (kopje), të nënshkruara nga pranuesi i shërbimeve për kontratat e cekura në listë.". Pas analizimit të të gjitha referencave dhe dëshmive të dorëzuara në ofertën e OE i rekomanduar, eksperti pasqyron se OE i rekomanduar ka dorëzuar me ofertë pesë referenca për punë të ngjashme ashtu siç është kërkuar dhe shuma totale e këtyre pesë referencave te cilat përmbushin kriteret e kërkuara është 58.316.52 euro. Referenca e fundit e dorëzuar si pjesë e listës së kontratave të ngjashme është dëshmi e qarkullimit bankar për tre vitet e fundit dhe nuk mund të merret si dëshmi e kontratave të ngjashme. Shuma e këtij konfirmimi nga banka sa i përket qarkullimit, nuk mund të kalkulohet si pjesë e shumës së kërkuar për të përmbushur kriterin e kontratave të ngjashme për tre vitet e fundit. Po ashtu, eksperti sqaron se AK ka bërë kërkesë për sqarim, ku OE i rekomanduar ka dorëzuar përmes kësaj kërkese edhe pesë referenca të tjera shtesë të cilat nuk janë fare pjesë e listës së referencave e dorëzuar me ofertë. Sipas mendimit të ekspertit, dy nga këto referenca nuk kanë as datë të lëshimit, megjithatë edhe për referencat e tjera të cilat kanë një datë të lëshimit e cila është para datës së hapjes së ofertave, sipas ekspertit të gjitha këto referenca shtesë (referenca 3-0; 3-3; 3-4, 3-5 dhe 3-6 të kërkesës për sqarim, e dorëzuar në AK) përbëjnë ndryshim material të ofertës, për faktin se asnjëra prej tyre nuk është përfshirë në listën e referencave fillestare në ofertë dhe si të tilla nuk mund të vërtetohen në mënyrë objektive se me të vërtetë kanë ekzistuar edhe para hapjes së ofertave. Andaj, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga OE ankues është i bazuar. "Lista e stafit duhet të dorëzohet në origjinal e cila duhet të përmbajë Emrin, Mbiemrin, Profesionin, Eksperienca (vitet) dhe pozicioni në kompani" Ky dokument fare nuk është dorëzuar nga kompania e rekomanduar për dhenje te kontratës. Gjithashtu autopriteti kontraktues ne dosjen e tenderit tek aftësitë teknike dhe profesionale ka kërkuar: 2.OE duhet të prezentoj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt të ketë : 1.Inxhinjer elektrikes 2.Inxhinjer i makinerisë 3.Inxhinjer i ndërtimtarisë 4.Ekspert gjyqësorë financiar i licencuar nga KGJK 5.Ekspert për vlerësim të pasurisë së paluajtshme i licencuar 6.Kontabilist të certifikuar/Auditor i brendshëm i certifikuar 1.2.3. CV, diploma origjinal ose e noterizuar , kontrata e punës me ofertuesin e nënshkruar nga të dy palët ,referenca për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit 4.5.6- CV, Licenca /Certifikata origjinal ose e noterizuar valide , kontrata e punës me ofertuesin e nënshkruar nga të dy palët ,referenca për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit. Ndërsa operatori ofertues i rekomanduar për dhenje te kontratës nuk i përmbush këto kritere ngase Për pozitën inxhinjeri i makinerisë kompania nuk ka dorëzuar referencat për punët e mëparshme të stafit të propozuar. Për pozitën inxhinjer i ndërtimtarisë diploma nuk është e noterizuar si dhe vërtetimi I noterit nuk tregon se çfarë kopje është si dhe nuk përkon me vulën që është vendosur në diplomën ku edhe vula e noterit është kopje. Për këtë staf gjithashtu mungojnë referencat për

punët e mëparshme të personit të propozuar. Ekspert financiar gjyqësor nuk ka asnjë referencë për punë të ngjashme. Ekspert për vlerësim të pasurisë së paluajtshme i licencuar asnjëri nga stafi I propozuar nuk ka asnjë referencë për punët e mëparshme të lëshuara nga punëdhënësit.
Konstatimi i katërt (IV): "Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve" Ky pretendim i ngritur nuk është një pretendim ankimor, sepse nuk përmbanë asnjë fakt apo provë e cila mund të shqyrtohet nga ana e ekspertit shqyrtues."
Konstatimi i pestë (V): "Pretendimi 5 "Neni 69 i LPP-së- Aftesia teknike dhe profesionale." Për këtë pretendim ankimor të ngritur eksperti shqyrtues është përgjigjur në pretendimin e tretë, pasi që OE ankues ka ngritur çështjet e njëjta."
Konstatimi i gjashtë (VI): "Autoriteti kontraktues shkel nenin 108/A me rastin e rishqyrtimit sipërfaqësor te kërkesës sonë për rishqyrtim. Nga 5 pretendime ankimore te ngritura nga ana jone, nga vendimi i AK-se i datës 22.11.2023 i paska rishqyrtuar vetëm 3 prej tyre. Madje edhe ato shkel e shko. Mjafton te shihni vendimin e AK ku dokumenti nuk është i strukturuar. Mjafton te shikoni arsyetimin nr.3 "3.(Pretendimi Nr.3) Sipas A.K. është i pabazuar sipas kërkesës te D.T. dhe njoftimit për kontrate sepse është devijim substancial qe nuk ndryshon vendimin e A.K.", Kur te gjeturat janë substanciale, ato automatikisht do duhej te ndryshonin vendimin e AK." Sipas ekspertit, AK në vendimin e kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga ana e OE ankues, ka dhënë përgjigje për pretendimet ankimore, edhe pse këto përgjigje nuk kanë qenë të arsyetuara në mënyrë të qartë, megjithatë vlerësojmë se AK është përgjigjur pretendimeve ankimore. Andaj, konsiderojmë që ky pretendim është pjesërisht i bazuar."
- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*
Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Rivlersim i Aseteve te NP"Termokos"Sh.A" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.sha-23-11074-2-2-1". Paneli shqyrtues vlerëson se pretendimet e ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale si dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë. Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues : OE "Shqiptar Jashari B.I."- Prishtinë janë pjesërisht të bazuara. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si pjesërisht e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rivlersim i Aseteve te NP"Termokos"Sh.A" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.sha-23-11074-2-2-1" të kthehet në rivlerësim, po ashtu, Paneli vlerësin se në bazë të arsyetimit dhe konstatimit të ekpsertit shqyrtues shqyrtues si dhe duke u bazuar në dispozita ligjore konketisht në nenin 59, 60, 69 të LPP, si dhe në bazë të neneve 38.2, 45.19 dhe 45.20 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, rezulton se OE të rekomanduar për kontratë nga ana e AK edhe pas sqarime nga ana e AK, nuk ka arritë të plotësoj Kërkesat e Dosjes së Tenderit, andaj, është i papërgjegjshëm për këtë aktivitet të prokurimit.
Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe

dokumentacionit të lëndës , ankesën e operatorit e sheh si pjesërisht të bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me titull "Rivlersim i Aseteve te NP"Termokos"Sh.A" me nr. të prokurimit: "NP Termoskos.sha-23-11074-2-2-1" të kthehet në Rivlerësim, AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.
Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.
Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **Ngrohtorja e Qytetit Termokos Sh.A.**
- OE - **Shqiptar Jashari B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: